



REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranimi / Dostizmat Prilipi / Prilipi Bashkimi / Bashkimi	26-04	3	vit god Stat
Organ / Organizata Org. / Organizata	In. Për In. Për	Shkup. / Shkup. /	Sasia Sasia
SKANSHEK	3834 / 2023		1/4



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.415/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Ardit Haxhnikaj-Demi dhe Eshref Shabani-anëtar, me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.415/2023 të datës 24.02.2023 të parashtruar nga ankuesi _____, nga Prishtina, kundër organit të punësimit Ministria e Industrisë, Ndërmarrësië dhe Tregtisë, në çështjen juridike "vlerësim i rezultateve në punë", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 26.04.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa A.nr.415/2023 e datës 24.02.2023, e parashtruar nga ankuesi _____.
- II. Mbetet në fuqi Formulari për vlerësimin e rezultateve të punës për vitin 2022, i datës 31.01.2023 për ankuesin, si në piken 1 të këtij vendimi.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil, _____ (në vijim referuar ankuesi), i punësuar në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, me datën 24.02.2023, ka parashtruar ankesë me numër të protokollit 2048/2023, kundër Formularit për vlerësimin e rezultateve të punës për vitin 2022, me pretendimet ankimore se vlerësimi i bërë nga mbikëqyrësi i tij i drejtpërdrejt është vlerësim tepër i ulët, degradues dhe jo motivues dhe i njëjti kërkon që Këshilli pas shqyrtimit të ankesës të anulohet vlerësimin e rezultateve në punë duke bazuar në dëshmitë e bashkangjitura.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tej referuar Këshilli) me datën 28.02.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën në Ministrinë e Industrisë,

Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, ndërsa kjo e fundit me datën 07.03.2023 përmes Divizionit për Burime Njerëzore, ka përcjellë dokumentacionin lidhur me këtë lëndë.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, bazuar në dispozitat e nenit 17 paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 12.04.2023 me Vendimin me numër protokolli 3477/2023 ka vazhduar afatin për vendimmarrje edhe për 10 ditë pune lidhur me ankesën A.nr.415/2023 të datës 24.02.2023, e parashtruar nga ankuesi

Kolegji i Këshillit, pas konstatimit se ankesa është e pranueshme në kuptim të dispozitave të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi për shqyrtimin e të njëjtës, kështu që për vendosje meritori administroi këto prova: Ankesën e datës 24.02.2023 me Nr.prot:2048/2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt emërimit e ankuesit të datës 21.06.2019 së bashku me përshtkrimin e detyrave të punës të datës 23.03.2017; E-mailin zyrtar të datës 09.02.2022, 04.03.2022, 08.02.2022, 05.04.2022, 16.05.2022, 09.06.2022, 09.06.2022, 08.07.2022, 05.07.2022, 16.08.2022, 15.08.2022, 19.09.2019; 09.09.2022, 10.10.2022, 03.10.2022, 09.11.2022, 12.12.2022, 09.12.2022, 12.01.2023, 18.10.2022; Raportin vjetor për vitin 2022 të ankuesit; E-mailin zyrtar të datës 26.09.2022; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2022 të datës 31.01.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 28.02.2023 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 07.03.2023 nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2021 për ankuesin; Raportin vjetor për vitin 2022 të ankuesit; Raportin vjetor të datës 03.01.2021 nga ankuesi; E-mailin zyrtar të datës 13.01.2023, 16.12.2022, 26.01.2023, 17.01.2023, 16.01.2023; 14.12.2022, 13.12.2022, 16.01.2023, 14.12.2022, 09.02.2022, 01.09.2022, 15.04.2022, 28.03.2022, 24.02.2022, 16.03.2022, 25.02.2022, 09.02.2022, 08.02.2022, 06.03.2022, 27.12.2022 dhe 30.01.2023 dhe Vendimin VK/2023 të datës 12.04.2023 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës lidhur me vazhdimin e aftit të ankuesit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar provat materiale të çështjes në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesi Dardan Dobruna është e **pa bazuar, sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se ankuesi sipas Akt Emërimit të datës 21.06.2019, është i punësuar në pozitën e punës *Zyrtar për të Hyra Financiare*, në kuadër të Agjencisë për Pronësi Industriale - Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

Udhëheqësi i Sektorit për Patenta në cilësi të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të ankuesit, me datë 31.01.2023 ka bërë vlerësimin e rezultateve të punës për ankuesin për vitin 2022 përmes sistemit SIMBNJ, duke e vlerësuar të njëjtin lidhur me objektivat e punës me notë mesatare 2.3, kurse për aftësitë e përgjithshme me notë mesatare 1.7, respektivisht me notën e përgjithshme prej 2.1, që në kuptim të nenit 11 paragrafit 1 nën paragrafit 1.2 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, nënkupton vlerësim i kënaqshëm apo mjaftueshëm.

Ankuesi i pakënaqur me këtë vlerësim, brenda afatit ligjor parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me pretendimet ankimore së vlerësimi i bërë nga mbikëqyrësi i tij i drejtpërdrejtë është vlerësim tepër i ulët, degradues dhe jo motivues, i njëjti



thekson se udhëheqësi i tij i drejtpërdrejtë nuk i ka dhënë hapësirë lidhur me diskutimin për vlerësim, kërkon që Këshilli ta trajtoj ankesën e tij si dhe ta anuloj Formularin mbi vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2022.

Kolegji i Këshillit lidhur me shqyrtimin e pretendimeve të ngritura në ankesë, ka analizuar nenin 43 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, më të cilin përcaktohet se: *1. Vlerësimi i rezultateve në punë është proces i përhershëm, që përfshin vlerësimin e realizimit të objektivave të paracaktuar dhe vlerësimin e sjelljes profesionale të nëpunësit civil në realizimin e objektivave. Periudha e vlerësimit zgjat 1 vit dhe fillon nga 1 janari dhe mbaron më 31 dhjetor. Vlerësimi bëhet deri më 31 janar të vitit të ardhshëm, për vitin pasues. 2. Vlerësimi i rezultateve në punë bazohet në objektivat e paracaktuar në mënyrë individuale për nëpunësin që vlerësohet, në përputhje me përshkrimin përkatës të punës dhe objektivat e njësisë apo institucionit.....”* dhe nenin 5 paragrafin 1 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, ku përcaktohet se : *1. Vlerësimi i rezultateve në punë për nëpunësin përbëhet prej fazave, si në vijim: 1.1. përcaktimin e objektivave; 1.2. vlerësimin e progresit të arritur gjatë periudhës së vlerësimit, për realizimin e objektivave të paracaktuar; dhe 1.3. vlerësimi në fund të periudhës vlerësuese (vlerësimi përfundimtar),* dhe si rrjedhojë në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji i Këshillit konstaton se pretendimet ankimore të ankuesit nuk janë të bazuara ngase se ankuesi përveç raportit vjetor, nga shkresat e lëndës rrjedh se nuk ka bashkangjitur të detajuar raportet qoftë javore apo mujore me të cilat konstatohet gjendja mbi kryerjen e punëve dhe aktiviteteve nga ana e tij e të cilat janë të pasqyruara gjatë periudhës së vlerësimit, duke listuar këto aktivitete për secilën fushë veç e veç, mirëpo vetëm janë të bashkangjitura e-maile zyrtare si dokumente të dërguara e në bazë të të cilave Kolegji e ka të pamundur të vlerësoj punët e kryera gjatë gjithë periudhës vlerësuese.

Kolegji i Këshillit ndërlidhur me këtë fushë, po ashtu ka gjetur se udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankuesit me datën 23.01.2023, përmes e-mailit zyrtar ka përcjell formularin e vlerësimit të ankuesi, për diskutim, ndërsa me datën 26.01.2023 përmes e-mailit zyrtar e ka ftuar në takim të njëjtin lidhur me diskutimin e formularit të vlerësimit, për vitin paraprak, nga rrjedh se i njëjti ka qenë në dijeni lidhur me këtë veprim, mirëpo që i njëjti nuk ka dhënë asnjë koment apo nuk ka shprehur pakënaqësi në këtë formular të vlerësimit lidhur me vlerësimin për vitin paraprak apo dhënien e sugjerimeve, të cilat do të kishin qenë të nevojshme për faktin se nga ankuesi do të ishin ofruar prova shtesë në atë drejtim rreth ofrimit të fakteve se i njëjti do të meritonte një vlerësim më të mirë dhe meritator, e që në rastin konkret mbikëqyrësi i tij do duhej t'i kishte marrë për bazë në rast të rivlerësimit të tij.

Nga analizimi i kësaj çështje ankimore, Kolegji i Këshillit mori për bazë po ashtu edhe faktin se ankuesi sipas Vendimit Nr.1523-KOM të datës 16.03.2022 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, për shkak të shkeljeve të detyrave të punës i është shqiptuar masa disiplinore *“Ndalim në pagë 20% në periudhën prej gjashtë (6) muajve”*, vendim ky i konfirmuar si i drejte dhe i ligjshëm edhe me Vendimin A.nr.350/2022 të datës 20.05.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Andaj, duke qenë se vlerësimi i rezultateve në punë nënkupton një proces të përhershëm që përfshin vlerësimin e realizimit të objektivave dhe vlerësimin e sjelljes profesionale të nëpunësit civil, dhe meqenëse ankuesi me dëshmitë dhe shkresat e lëndës, nuk ka arritur të dëshmoj me prova se ka arritur t'i përmbush objektivat dhe detyrat e tij të punës, në atë drejtim duke siguruar



dëshmi të mjaftueshme për pasqyrimet në lidhje me aktivitetet e kryera veç e veç, si dhe duke marr parasysh faktin se ankuesi për sjelljet e tij ka një mase të konfirmuar disiplinore nga organi i punësimit, Kolegji i Këshillit vlerëson se pretendimet ankimore të ankuesit se vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2022 është vlerësim tepër i ulët, degradues dhe jo motivues, nuk janë të bazuara.

Për sa me sipër dhe duke u bazuar në nenin 13 paragrafin 4 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, Kolegji i Këshillit e lënë në fuqi Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2022, për ankuesin, ngase pas analizimit të njëjtit ka konstatuar se ankuesi ka arritur t'i përmbush vetëm disa nga objektivat e punës si dhe ka treguar aftësi në pritjet siç përcaktohet edhe me nenin 11 paragrafin 2 nën paragrafin 2.4, të kësaj rregulloreje ku decidivisht përcaktohet se: *"kënaqshëm ose mjaftueshëm"*, vlerësohet nëpunësi, i cili ka realizuar vetëm disa nga objektivat e punës dhe ka treguar aftësi nën pritjet. Kontributi i tij nuk ka ndikuar, ose ka ndikuar vetëm pjesërisht në realizimin e objektivave dhe performances e përgjithshme të institucionit", ndërsa ankuesi me shkresa të lëndës nuk ka mundur të argumentoj të kundërtën, kështu që në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit vlerësimi i ankuesit nga ana e udhëheqësit të tij të drejtpërdrejtë për vitin 2022, është në harmoni me legjislacionin në fuqi.

Rrjedhimisht, Kolegji i Këshillit konstaton se vlerësimi i rezultateve në punë për ankuesin është bërë në pajtim me nenin 43 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenin 4 dhe 5 të Rregullores Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, kështu që në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe nenit 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.415/2023.

Ardita Perçuku-Shyti

Procesmbajtëse



Vendimi i dërgohet

- Ankuesit,
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.